



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.55

12 maj

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9717
datë 19.4.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Bankës së Këshillit të Europës për 1435 Zhvillim”

LIGJ
Nr.9717, datë 19.4.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR TË HUASË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE DHE
BANKËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR ZHVILLIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Bankës së Këshillit të Europës për Zhvillim” për financimin e projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”, nëpërmjet kredisë prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5292, datë 8.5.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE
NDËRMJET BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EUROPËS DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE QË PËRFAQËSON REPUBLIKËN E SHQIPËRISË BANKA E ZHVILLIMIT E
KËSHILLIT TË EUROPËS, ORGANIZATË NDËRKOMBËTARE, PARIS, KËTU E TUTJE
REFERUAR SI CEB), NGA NJËRA ANË DHE KËSHILLI I MINISTRAVE QË PËRFAQËSON
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, QË PËRFAQËSOHET NGA MINISTRIA E FINANCAVE
(KËTU E TUTJE REFERUAR SI HUAMARRËSI),

duke pasur parasysh kërkesën e paraqitur nga Qeveria e Shqipërisë (Anëtare), të datës 23 qershor 2006;

duke pasur parasysh Rezolutën e Këshillit Administrativ të CEB-it: 1480 (2004);

duke pasur parasysh Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Europës;

duke pasur parasysh Rregulloret e Huasë të CEB-it, të datës 6 tetor 1970;

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme

Kjo hua jepet në bazë të kushteve të përgjithshme të rregulloreve të tashme të huasë të CEB-it dhe në bazë të kushteve të veçanta të përcaktuara nga kjo Marrëveshje kuadër huaje (këtu e tutje referuar si Marrëveshje), shtojcave të saj dhe letrave shoqëruese (këtu e tutje të referuara si letra shoqëruese).

Neni 2

Projekti

CEB-i i jep Huamarrësit, i cili pranon një hua për financimin e pjesëshëm të F/P 1570 (2006) Programi Arsimor për Cilësi dhe Barazi (EEE-P) të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it më 6 shtator 2006. EEE-P-i bashkëfinancohet nga Qeveria e Shqipërisë, Banka Botërore/Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit dhe Banka Europiane e Investimeve. EEE-P-i synon përmirësimin e cilësisë së kushteve të të mësuarit për të gjithë studentët dhe regjistrimin e gjerë në arsimin e mesëm të përgjithshëm, veçanërisht për të varfrit.

Kjo hua jepet nga CEB-i duke pasur parasysh zotimin që Huamarrësi po tregon për ta zbatuar atë vetëm për të financuar projektin e përshkruar në shtojcën 1 (këtu e tutje referuar si Projekti), dhe për të kryer këtë projekt në kushtet që janë detajuar në këtë shtojcë.

Çdo ndryshim për mënyrën se si zbatohet huaja që nuk merr pëlqimin e CEB-it mund të çojë në pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të huasë, sipas kushteve të nenit 13 të rregulloreve të huasë.

Neni 3

Huaja

3.1 Kushtet financiare

Shuma e huasë që jepet është:

14 000 000 euro

katërmëdhjetë milionë euro

Ajo disbursohet me këste sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën 1.

Për çdo këst, shuma, interesi, monedha, data e disbursimit, periudha e shlyerjes dhe çdo llogari e secilës palë për transferimin, përcaktohen së bashku nga Huamarrësi dhe CEB-i me faks. Monedha për këstet do të jetë euro ose dollari amerikan.

Një letër shoqëruese e kësaj Marrëveshjeje, që përcakton kushtet për secilin këst, përpilohet në momentin e disbursimit, kryesisht në formën e përcaktuar në shtojcën 2.

Interesi për secilin këst të huasë subvencionohet nga llogaria selektive e trustit të CEB-it. Ky subvencion nuk mund të kalojë 3 360 000 euro për të gjithë shumën e projektit të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it. Subvencioni zbatohet në mënyrë proporcionale për çdo transh të huasë. Subvencioni është llogaritur me 300 pikë bazë në vit (3.00%) mbi bazën e një huaje me afat 10-vjeçar që përfshin një periudhë 5-vjeçare pa pagesa. Megjithatë, në rast se interesi para subvencionit do të ishte nën shkallën e subvencionit, subvencioni është i barabartë me atë shkallë.

3.2. Disbursimi

Disbursimi i huasë, në disa këste, bëhet në pajtim me ecurinë e punës së Projektit. Kërkesat për disbursime i paraqiten CEB-it nga Huamarrësi.

Disbursimi i parë duhet të ndodhë jo më vonë se 18 muaj pas datës së miratimit të Projektit.

Një këst paraprak deri në 40% të shumës së miratuar të huasë disbursohet në një llogari të regjistruar që mund të auditohet nga CEB-i.

Disbursimet pasuese bazohen në deklaratimet e Huamarrësit në lidhje me gjendjen e ecurisë (dhe mbi parashikimet për përparimin e punëve në këtë vit).

Këstet pasuese disbursohen menjëherë sapo të jetë përdorur kësti pararendës.

3.3. Mobilizimi

Me qëllim që të mobilizohen këstet e huasë, Huamarrësi i dërgon CEB-it para çdo disbursimi shënimin e bashkangjitur premtues (shtojca 3) për çdo këst.

Shënimi Premtues lëshohet dhe paguhet në monedhën që është paguar kësti.

3.4. Vendi i pagesës

Të gjitha shumat e kërkueshme për Huamarrësin në bazë të kësaj huaje paguhet në monedhën e secilit këst në numrin e llogarisë që i bëhet i ditur nga CEB-i Huamarrësit në momentin e disbursimit, me njoftim me faks që i dërgohet CEB-it nga banka që udhëzohet nga Huamarrësi për pagesën, të paktën katër dite pune para secilës pagesë.

3.5. Datat

Dispozitat e nenit 3 i nënshtrohen Konventës së Modifikuar pas Ditës së Punës. Konventa e Modifikuar pas Ditës së Punës është një konventë me anë të së cilës nëse një datë e përcaktuar do të binte në një ditë që nuk është një ditë pune (Ditë pune) është një ditë në të cilën operon sistemi TARGET (Trans-European Automated Real-Time Gross Settlement Express Transfer System), kjo datë do të jetë dita e parë pas ditës që është ditë pune, përveç kur kjo ditë bie në muajin tjetër kalendarik, dhe në këtë rast kjo datë do të ishte dita menjëherë para një dite pune.

Neni 4

Monitorimi i huasë dhe Projektit

4.1.1. Afati

Këstet duhet t'u paguhen nga Huamarrësi përfituesve përfundimtarë brenda 12 muajve pas çdo disbursimi.

Pjesa e të ardhurave të huasë që nuk përdoren ose alokohen brenda një afati të tillë, duhet t'i kthehen CEB-it, jo më vonë se brenda 30 ditëve.

Huamarrësi merr përsipër të përballojë shpenzimet që rrjedhin nga kjo shlyerje. Këto shpenzime janë të barabarta me ato që duhet të pësojë CEB-i për shkak të zhvendosjes së të njëjtës shumë në datën e shlyerjes për periudhën e huasë fillestare. Shkalla e zëvendësimit përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e shlyerjes dhe për periudhën në fjalë. Kështu, shpenzimet llogariten duke marrë parasysh diferencën ndërmjet shkallës fillestare dhe asaj të zëvendësimit.

4.1.2. Zbatimi i Projektit

Ky Projekt zbatohet nga Huamarrësi nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) që është përgjegjëse për zbatimin e të gjithë Projektit, duke përfshirë caktimin e prioriteteve dhe bashkërendimin e aktiviteteve të Projektit, përgatitjen e programeve vjetore të reformës, dhe monitorimin e detyrimeve dhe garancive. EEE-P-ja zbatohet nga MASH-i, duke përdorur personelin dhe strukturën e saj ekzistuese.

Mbikëqyrja e politikës dhe drejtimi i EEE-P-së do të jetë përgjegjësi e Komitetit Drejtues, që përbëhet nga ministrat dhe zëvendësministrat dhe nëpunës të tjerë që përfaqësojnë autoritetet shqiptare të përfshira në EEE-P-në.

Çdo vit, MASH-i do të organizojë mbledhje gjashtëmuajore rishikuese me autoritetet shqiptare dhe institucionet financiare ndërkombëtare të përfshira në EEE-P. Këto mbledhje rishikuese priten të shërbejnë si një mekanizëm për planifikimin, monitorimin dhe vendimmarrjen.

Huamarrësi nëpërmjet MASH-it tregon të gjithë kujdesin dhe vëmendjen dhe zbaton të gjitha mjetet e përdorshme përkatëse, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxheriale dhe ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit, që janë të nevojshme për zbatimin e përshtatshëm të Projektit.

Nëse shpenzimet e Projektit rriten ose rishikohen për një arsye të caktuar sipas përshkrimit në shtojcën 1 të bashkangjitur, Huamarrësi siguron që të sigurohen mjete financiare shtesë për përfundimin e Projektit.

Veçanërisht ai siguron – para zbatimit të Projektit – që të gjitha të drejtat pasurore të tokës dhe reale që janë të nevojshme për këtë, të zotërohen dhe të gjitha sendet pasurore dhe impiantet të sigurohen dhe të mirëmbahen gjithmonë.

Huamarrësi, nëpërmjet MASH-it, merr përsipër mbi të gjitha që:

- Projekti të jetë në pajtim me konventat përkatëse të Këshillit të Europës;
- Projekti t'i jetë nënshtruar një vlerësimi ambientalist lokal, bazuar në kuadrin ligjor shqiptar;
- financimi i pjesshëm nga CEB-i nuk kalon 50% të shpenzimeve totale të Projektit, duke përjashtuar pagesat e interesave dhe financiare, që janë parashikuar në shtojcën ¹.

4.1.3. Prokurimi

CEB-i lejon që i gjithë prokurimi i punëve, mallrave dhe shërbimeve që financohen brenda Projektit nga shuma e huasë së CEB-it të bëhet në pajtim me udhëzimet e fundit të BANKËS BOTËRORE për prokurimet, duke përdorur dokumentin e fundit standard të BANKËS BOTËRORE

dhe Udhëzimet e fundit të BANKËS BOTËRORE për përzgjedhjen dhe zotimin e konsulentit, si dhe pragjet ose masa të tjera për prokurimet që përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar nga Huamarrësi me Agjencinë Ndërkombëtare të Zhvillimit (EDA).

Megjithatë, CEB-i nuk lëshon asnjë “vërtetim për moskundërshtim” në lidhje me masat e prokurimeve të propozuara nga Huamarrësi, duke përfshirë paketat e kontratave, procedurat e zbatueshme, por rezervon të drejtën për të proceduar me shikimin paraprak ose pasues, me bazë kampionësh, të masave të prokurimit të propozuara nga Huamarrësi, duke përfshirë paketat e kontratave, procedurat e zbatueshme, dhe afatet e procesit të prokurimit, për përputhshmërinë e tij me udhëzimet e BANKËS BOTËRORE dhe programet e propozuara të zbatimit dhe afatet e disbursimit.

CEB-i nuk financon shpenzimet për financime për mallrat dhe punimet që nuk janë parashikuar në Marrëveshjen e Huasë dhe që janë shtjelluar në tej në planin e prokurimit të rënë dakord me Bankën Botërore. Në këto raste, CEB-i do të deklarojë keqprokurimin dhe është politika e CEB-it të anulohet pjesën e huasë që alokohet për mallra dhe punime që janë keqprokuruar. Edhe menjëherë pas dhënies së kontratës pas marrjes së “vërtetimit të moskundërshtimit” nga Banka Botërore, CEB-i mund të deklarojë përsëri keqprokurimin, nëse ajo nxjerr përfundimin që “vërtetimi i moskundërshtimit” është lëshuar mbi bazën e informacionit të paplotë, të pasaktë ose të pavërtetë të dhënë nga Huamarrësi ose kushtet dhe termat e kontratës janë ndryshuar pa pëlqimin e Bankës Botërore. Kjo do të përbente një rast që është renditur në nenin 13-h të kapitullit 3 të rregulloreve të huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose rimbursimin e parakohshëm të Huasë në bazë të kushteve të nenit 13 të rregulloreve të huasë.

Huamarrësi njofton menjëherë CEB-in për çdo vonesë ose ndryshime të tjera në afatet e procesit të prokurimit, që mund të ndikojë në mënyrë thelbësore në zbatimin në kohë dhe të suksesshëm të kontratave të projektit dhe bien dakord me CEB-in për masat rregulluese.

Në çdo rast përgjegjësia për zbatimin e Projektit, dhe kështu përgjegjësia për dhënien dhe administrimin e kontratave në bazë të Projektit, i mbetet Huamarrësit.

4.2. Raportet e Huamarrësit

4.2.1. Raportet e ecurisë të Projektit

Huamarrësi nëpërmjet MASH-it i dërgon CEB-it, në çdo dy vjet dhe çdo herë që kërkohet një disbursim i ri, një raport ecurie në anglisht, që përmban:

- gjendjen e përdorimit të huasë;
- ecurinë e planit të financimit të Projektit;
- progresin e vetë Projektit dhe veprimet e prokurimeve;
- të dhënat për menaxhimin e Projektit.

Shtojca 4 përmban formatin që përcakton informacionin minimal që kërkohet nga CEB-i për raportet e ecurisë. Mund të përdoren gjithashtu formatet alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

4.2.2. Raporti për përfundimin e Projektit

Me përfundimin e të gjithë Projektit, Huamarrësi me anë të MASH-it paraqet një raport përfundimtar, që përmban një vlerësim të efekteve ekonomike, financiare, sociale dhe ambientaliste të Projektit.

4.3. Dhënia e informacionit CEB-it

Huamarrësi me anë të MASH-it mban regjistrimin e llogarive në lidhje me Projektin, që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, që tregojnë në çdo moment gjendjen e përparimit të Projektit, dhe që tregojnë të gjitha operacionet e bëra, dhe identifikojnë sendet pasurore dhe shërbimet e financuara me ndihmën e kësaj huaje.

Huamarrësi me anë të MASH-it merr përsipër të presë pozitivisht çdo mision informimi që përmbushet nga nëpunësit e CEB-it ose konsulentët e jashtëm të angazhuar nga CEB-i dhe për të siguruar të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për misionin e tyre të informimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në vendin e Projektit. Veçanërisht, CEB-i mund të kryejë një auditim në vend të llogarive të Projektit të realizuar nga një ose më shumë konsulentë të zgjedhjes së saj me shpenzimet e Huamarrësit në rastin e qenies në vonesë nga Huamarrësi në lidhje me çdo detyrim të tij sipas kësaj huaje.

Huamarrësi me anë të MASH-it merr përsipër të përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm ndaj çdo kërkesë për informim nga CEB-i dhe t'i japë asaj çdo dokumentacion që CEB-i e konsideron të nevojshme dhe mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e rregullt të Marrëveshjes, veçanërisht në lidhje me monitorimin e Projektit dhe përdorimin e huasë.

Huamarrësi informon CEB-in menjëherë në lidhje me çdo ndryshim legjislativ apo në akte nënligjore në sektorin ekonomik që ka të bëjë me Projektin, dhe, në një kuptim të përgjithshëm, për çdo rast që mund të ketë ndikim në përmbushjen e detyrimeve të tyre në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim legjislativ ose në aktet nënligjore në sektorin ekonomik që ka të bëjë me Projektin, do të përbënte një ngjarje të renditur në nenin 13-h të kapitullit 3 të rregullores së huasë të CEB-it dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të huasë.

Neni 5

Përmbushja e detyrimeve të Huamarrësit

Pagesa e shumave të kërkueshme të parashikuara në shënimet premtuese e liron Huamarrësin nga detyrimet e tij të përcaktuara në seksionin 3.1 më sipër.

Pasi shuma e plotë e principalit të kësaj huaje dhe të gjitha interesat dhe shpenzimet që rrjedhin prej tyre, veçanërisht shumat sipas neneve 6 dhe 7 më poshtë, paguhet rregullisht, Huamarrësi mund të lirohet rregullisht nga detyrimet e tij kundrejt CEB-it, me përjashtim të atyre të parashikuara në nenin 4 më sipër.

Neni 6

Interesi për vonesat

Pavarësisht mjeteve të tjera që ka CEB-i në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe rregulloreve të huasë apo nëse Huamarrësi nuk e paguan të gjithë interesin ose ndonjë shumë të pagueshme në bazë të Marrëveshjes brenda periudhës së parashikuar për pagesën, Huamarrësi duhet të paguajë interes shtesë për shumën e kërkueshme që nuk është paguar plotësisht, në shkallën një muaj EURIBOR¹ për monedhën e pagesës së fundit që nga data që bëhet e kërkueshme (nëse nuk është një ditë pune TARGET, dita e parë pasuese e punës) më 11 para dite (ora e Brukselit), plus 2.5% në vit, që nga data e kërkueshmërisë së kësaj shume deri në datën e kësaj pagese.

Shkalla e zbatueshme një mujore EURIBOR² përditësohet çdo 30 ditë.

Neni 7

Shpenzimet dytësore

Të gjitha pagesat dhe taksat e të gjitha llojeve, të kërkueshme dhe të paguara, dhe të gjitha shpenzimet që rrjedhin ose nga përfundimi, ekzekutimi, likuidimi, anulimi ose pezullimi i Marrëveshjes, plotësisht ose pjesërisht, ose nga garancia ose rifinancimi i huasë së dhënë, së bashku me të gjitha veprimet gjyqësore dhe jogjyqësore që kanë si origjinë këtë hua, përballohet nga Huamarrësi.

Megjithatë, dispozitat e nenit 25 të kapitullit 4 të rregulloreve të huasë të CEB-it zbatohen në lidhje me shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të përmendur në kapitullin 4.

Neni 8

Letrat me vlerë

Huamarrësi deklaron që asnjë detyrim tjetër nuk është marrë përsipër apo do të merret në të ardhmen që do t'i jepte një pale të tretë një radhë preferenciale, ose një radhë preferenciale pagese,

¹ Nëse monedha është USD “shkalla mujore USD LIBOR” që nga data e kërkueshme (nëse është e shtunë, e dielë ose një ditë pushimi për bankën, dita e parë pasuese e punës) në orën 11 (ora lokale në Londër).

² Nëse monedha është USD “shkalla mujore USD LIBOR” që nga data e kërkueshme (nëse është e shtunë, e dielë ose një ditë pushimi për bankën, dita e parë pasuese e punës) në orën 11 (ora lokale në Londër).

kolateral ose garanci e çdo natyre që do t'u jepnin palëve të treta të drejta të avancuara (këtu e tutje referohen si letra me vlerë).

Nëse një letër e tillë me vlerë i jepet një pale të tretë, Huamarrësi bie dakord të formojë ose të japë një letër identike me vlerë në favor të CEB-it ose, nëse nuk e bën dot këtë, një letër ekuivalente me vlerë dhe të parashikojë formimin e një letre të tillë me vlerë në favor të CEB-it.

Mospërbushja e këtyre dispozitave do të përfaqësonte një rast vonese sipas parashikimit të nenit 13-h të kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë të CEB-it dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të huasë.

Neni 9

Përfaqësimet dhe garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- që organet e tij kompetente e kanë autorizuar atë të lidhë Marrëveshjen dhe i kanë dhënë nënshkruesit autorizimin për këtë, në pajtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të;

- që hartimi dhe ekzekutimi i Marrëveshjes nuk bie në kundërshtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të dhe të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për këtë janë marrë dhe mbeten të vlefshme për të gjithë periudhën e huasë.

Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme, për të gjithë periudhën e huasë, duhet t'i njoftohet menjëherë CEB-it dhe t'i jepet çdo dokument shoqërues.

Neni 10

Raporti me palët e treta

Huamarrësi nuk mund të ngrejë asnjë fakt në lidhje me marrëdhëniet e tij me palët e treta në kuadrin e përdorimit të huasë, me qëllim që të shmangë përbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, pjesërisht ose plotësisht.

CEB-i nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshje që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe shpenzimet e çdo natyre të shkaktuara nga CEB-i për shkak të një kundërshtimi dhe veçanërisht të gjitha shpenzimet, ligjore dhe gjyqësore, përballohen nga Huamarrësi.

Neni 11

Mospërbushja e tërthortë opsionale e detyrimeve

Pezullimi, anulimi ose shlyerja e menjëhershme e huasë së Bankës Botërore në lidhje me EEE-P-në, pjesërisht ose plotësisht, lejon CEB-in, pas konsultimeve me Huamarrësin, të pezullojë, anulojë ose kërkojë shlyerjen e menjëhershme të kësaj huaje në pajtim me dispozitat e kapitullit 3, neni 13(h) të Rregullores së Huasë të CEB-it.

Neni 12

Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron që ai ka vërejtur rregulloret e huasë të CEB-it dhe ka marrë një kopje të tyre.

Nëse ka një kontradiktë ndërmjet çdo lloj dispozite të rregulloreve të huasë të CEB-it dhe çdo dispozite të Marrëveshjes, kanë përparësi dispozitat e Marrëveshjes.

Titujt e paragrafëve, seksioneve dhe kapitujve të Marrëveshjes nuk shërbejnë për interpretimin e tyre.

Në asnjë rast nuk prezumohet që CEB-i ka hequr dorë nga ndonjë e drejtë në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13
Ligji i zbatueshëm

Marrëveshja dhe garancitë e negociueshme në lidhje me të rregullohen nga rregullat e CEB-it sipas parashikimit të dispozitave të nenit 1 paragrafi 3 të Protokollit të Tretë të datës 6 mars 1959 të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Europës e datës 2 shtator 1949 dhe, si dytësore, sipas rasti, ligji francez.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në Marrëveshje i nënshtrohen arbitrazhit në kushtet e parashikuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huasë të CEB-it.

Neni 14
Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit

Palët kontraktuese bien dakord të mos përdorin asnjë privilegj, imunitet apo legjislacion para një autoriteti juridiksional ose tjetër, vendas ose i huaj, me qëllim që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë në kushtet e parashikuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huasë të CEB-it.

Neni 15
Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër që i jepet ose i bëhet në bazë të kësaj Marrëveshjeje CEB-it ose Huamarrësit bëhet me shkrim dhe mendohet të jetë dhënë ose bërë rregullisht nëse ai jepet dorazi, postë ajrore ose faks nga njëra palë drejtuar tjetrës në adresën e palës të përcaktuar më poshtë.

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Tiranë, Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Fax. 355 4 228 494
Për CEB-in:
Council of Europe Development Bank
55 Avenue Kleber
75116 Paris
Në vëmendje të: Drejtor i Përgjithshëm, Hua
Fax +33 1 47 55 37 52.
Të gjitha komunikimet jepen ose bëhen në gjuhën angleze.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me ratifikimin e saj nga Parlamenti Shqiptar.

Neni 17
Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hartohet në dy origjinale në gjuhën angleze, secila prej të cilave është njëllor e vlefshme.

Një kopje origjinale mbahet nga secila prej Palëve Kontraktuese.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**I.**

F/P	1570(2006)
Huamarrësi:	Shqipëri
Miratuar nga këshilli administrativ	6 shtator 2006 CA/PV/243/2006
Shuma e miratuar	14 000 000 euro

II.

Sferat e ndërhyrjes	Arsimi
Punët e planifikuara:	Projekti synon të përmirësojë cilësinë e kushteve të të nxënësve në arsimin fillor; duke rritur regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe duke forcuar qeverisjen në sektorin e arsimit të lartë. Projekti ndërton dhe mbështet drejtpërdrejt zbatimin e masave të reformës, të identifikuar në fazën e parë të strategjisë së arsimit kombëtar të Shqipërisë. Projekti është i organizuar në komponentët e mëposhtëm: 1. Forcimi i menaxhimit, udhëheqjes dhe qeverisjes. 2. Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie dhe të nxënësve. 3. Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së arsimit 4. Caktimi i fazës për reformën në arsimin e lartë.
Lokalizimi:	Aktivitetet e mbështetura nga programi ndodhen në të gjithë territorin e Shqipërisë, në shkollat rurale dhe urbane
Shpenzimet e përgjithshme të vlerësuara të Projektit:	59 600 000 euro
Shpenzime të parashikuara (milionë euro) të shpërndara sipas zërave:	Shpenzimet e Projektit për zërat rishikohen çdo gjashtë muaj. Shpenzimet treguese të Projektit shpërndahen me zëra si më poshtë: 1. Forcimi i menaxhimit, udhëheqjes dhe qeverisjes. 7.90 2. Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie dhe të nxënësve. 20.68 3. Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së arsimit. 25.45 4. Caktimi i fazës për reformën në arsimin e lartë. 5.57 Shpenzimet e përgjithshme të parashikuara në Projekt 59.60
Plani i financimit	Kontributet e parashikuara nga financuesit janë si më poshtë: Financuesi milionë 1. Qeveria e Shqipërisë 30 USD 2. Banka e Zhvillimit e Këshillit të Europës 14.0 Euro 3. Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit 15 USD 4. Banka Europiane e Investimeve 12.5 Euro
Progresi i punëve në momentin e paraqitjes së kërkesës:	0%
Afati i punëve	2006 – 2010
Kushte të veçanta	Para kushtit të parë të huasë: - MASH-i i paraqet për rishikim CEB-it dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare programin vjetor të reformës për vitin pasues kalendarik, duke përfshirë shumat treguese të

	nevojshme për zbatimin e aktiviteteve; - MASH-i planifikon në buxhetin e saj të përgjithshëm një shumë që mbulon pjesën e saj të programit vjetor të reformës për vitin përkatës kalendarik; - Një memorandum mirëkuptimi (MoU) do të ketë hyrë në fuqi me: (a) nënshkrimin nga Huamarrësi, CEB-i, Banka Europiane e Investimeve (EIB), dhe Banka Botërore/Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA), dhe (b) nënshkrimin e marrëveshjeve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe EIB dhe IDA-s përkatësisht.
--	--

III.

Kriteret e përshtatshmërisë: (sipas sferës së ndërhyrjes)	Projekti përputhet me kriteret e përshtatshmërisë të përcaktuara në Res 1480 (2004).
---	--

IV.

Efektet sociale: (sipas sferës së ndërhyrjes)	Rreth 33 000 mësues do të përfitojnë nga programet e trajnimit, afërsisht 370 shkolla do të përfshihen në procesin e përmirësimit dhe afërsisht 153 000 studentë do të përfitojnë drejtpërdrejt ose jo nga EEE-P-ja.
---	--

Shtojca 2 A

Letër shoqëruese model për një hua të interesit të lëvizshëm

F/P 1570 – [numri] këst

BANKA E ZHVILLIMIT E KËSHILLIT TË EUROPËS LETËR SHOQËRUESE

Në kuadrin e Marrëveshjes së huasë e datës [data]
 Ndërmjet BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EUROPËS
 (këtu e tutje referuar si “CEB”)
 dhe
 Republikës së Shqipërisë
 (këtu e tutje referuar si “Huamarrësi”)
 Kjo letër shoqëruese dhe Marrëveshja kuadër e huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e miratuara për [numër] këstin, duke iu referuar nenit [numër] të Marrëveshjes kuadër të huasë.
 Shuma e huasë [monedha dhe shuma]
 Maturimi [numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat pa pagesë
 EURIBOR (ose LIBOR) [fut përkufizimin e EURIBOR ose LIBOR]
 Interesi luhatës EURIBOR ose LIBOR 3 ose 6 muaj plus ose minus [numër] pikë bazë [neto]
 në vit [pas heqjes së (numër) subvencionit i interesit për pikët bazë nga llogaria selektive].
 (Telerate [referencë] ose Reuters [referencë])
 Pagesa e interesit semestrale ose gjysmë viti për pagesat e prapambetura
 Fraksioni i numërimit të ditëve aktuale/360, modifikuar sipas konventës së ditës së punës
 Ditë e punës (EURO) është një ditë në të cilën operon sistemi TARGET (Trans-European automated Real-Time Gross Settlement Express Transfer).
 ose (të tjera) është një ditë pune në vendin e monedhës
 Data e disbursimit [data]
 Udhëzimet e Pagesës (Huamarrës)
 Numri i llogarisë (numër) ose (emri i bankës dhe qyteti) SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet

[emri i bankës dhe qytetit përkatës]

SWIFT CODE [shifër]

Udhëzimet e pagesave (CEB) Sipas nenit 3.4 të Marrëveshjes kuadër të huasë

[vendos sipas rastit]

{Teksti për interesin bazë LIBOR dhe struktura amortizuese e huasë

Interesi llogaritet për çdo [numër] afat mujor, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të jetë i fiksuar për dy ditë pune (në Londër) para çdo periudhe të re interesi. CEB-i do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo [numër] muaj. Pagesa e interesit kryhet më [ditë, muaj]¹ çdo vit, dhe për herë të parë [datë]. [Rendisni datat e shlyerjes dhe shumën principale të kërkueshme për çdo datë].

{Teksti për interesin bazë LIBOR dhe struktura amortizuese e huasë

Interesi llogaritet për çdo [numër] afat mujor, duke filluar nga data e disbursimit. Interesi do të jetë i fiksuar për dy ditë pune para çdo periudhe të re interesi. CEB-i do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo [numër] muaj. Pagesa e interesit kryhet më [ditë muaj]² çdo vit, dhe për herë të parë [datë]. [Rendisni datat e shlyerjes dhe shumën principale të kërkueshme për çdo datë]}.

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it në pajtim me udhëzimet e pagesave (CEB) të përshkuara më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së modifikuar pas ditës së punës”, përkufizimi i të cilës gjendet në nenin 3.5 të Marrëveshjes kuadër të huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit më [datë].

Me qëllim që të mobilizojë këtë kësht të huasë, Huamarrësi, në kohën e duhur, i dërgon CEB-it një shënim premtimi që përpunohet me këtë kësht. [shih shtojcën 3].

[Qyteti, datë]

Për Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Europës

[Qyteti, data]

Për [Emri i Huamarrësit]

Shtojca 2 B

Letër Shoqëruese Model për një hua të interesit të lëvizshëm

F/P 1570 – [numri] kësti

BANKA E ZHVILLIMIT E KËSHILLIT TË EUROPËS LETËR SHOQËRUESE

Në kuadrin e Marrëveshjes së huasë të datës [data]

Ndërmjet BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EUROPËS

(këtu e tutje referuar si “CEB”)

dhe

Republikës së Shqipërisë

(këtu e tutje referuar si “Huamarrësi”)

Kjo letër shoqëruese dhe Marrëveshja kuadër e huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e miratuara për [numër] këstin, duke iu referuar nenit [numër] të Marrëveshjes kuadër të huasë.

Shuma e huasë [monedha dhe shuma]

Maturimi [numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat pa pagesë

Interesi i përcaktuar (numri përqindje) [neto] në vit

Pagesa e interesit çdo gjysmë viti / çdo vit për shumat e prapambetura

Fraksioni i numërimit të ditëve 30/360 i parregulluar, modifikuar sipas konventës së ditës së

¹ Përmend 4 data për pagesat semestrale dhe 2 data për pagesa gjashtëmujore.

² Përmend 4 data për pagesat semestrale dhe 2 data për pagesa gjashtëmujore.

punës

Ditë e punës është një ditë në të cilën operon sistemi TARGET (Trans-European Automated Real-Time Gross Settlement Express Transfer)

ose (të tjera) është një ditë pune në vendin e monedhës

Data e disbursimit [data]

Udhëzimet e pagesës (Huamarrës)

Numri i llogarisë (numër) ose (emri i bankës dhe qyteti] SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet [emri i bankës dhe qytetit përkatës]

SWIFT CODE [shifër]

Udhëzimet e pagesave (CEB) Sipas nenit 3.4 të Marrëveshjes kuadër të huasë

Pagesat e interesit dhe principalit do të bëhen në pajtim me planin kohor të bashkëngjitur të ripagesave. Ndërsa interesi paguhet për herë të parë në [datë], principalit do të paguhet për herë të parë [datë].

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it në pajtim me udhëzimet e pagesave (CEB) të përshkruara më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së modifikuar pas ditës së punës”, përkufizimi i të cilës gjendet në nenin 3.5 të Marrëveshjes kuadër të huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit më [datë].

Me qëllim që të mobilizojë këtë kështu të huasë, Huamarrësi, në kohën e duhur, i dërgon CEB-it një shënim premtimi që përputhet me këtë kështu. [shih shtojcën 3].

[Qyteti, datë]

Për Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Europës

[Qyteti, data]

Për [Emri i Huamarrësit]

Shtojca 3A

Shënim premtues model për një hua me interes të përcaktuar

F/P 1570 – [n°]

SHËNIM PREMTUES

[MONEDHA]

[SHUMA]

[DATË]

PËR VLERËN E MARRË, i nënshkruari:

Me anë të këtij shënimi premtues premtim t'i paguajë Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës ose një tjetri, shumën principale prej:

[shumën në germa] [monedhën në germa],

Në këste në datat e përcaktuara këtu, dhe interesat siç tregohen më poshtë.

Në datat e përcaktuara më poshtë, pagesat bëhen sipas parashikimit këtu nga një shumë e përgjithshme që përbëhet nga rimbursimi i kërkueshëm për principalin dhe interesi për balancën e papaguar të principalit.

[DATË]

PRINCIPALI

[MONEDHA] [SHUMA]

[DATË]

PRINCIPALI

[MONEDHA] [SHUMA]

Pagesat e mësipërme bëhen në

[BANKËN KORRESPONDUESE TË CEB-it DHE REFERENCAT E LLOGARIVE],

Në favor të Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës, pa zbritur asnjë taksë, pagesë apo

tarifë të tashme ose të ardhshme që caktohet kundër këtij shënimi, ose të ardhurave të saj nga ose në [fut Shtetin përkatës] apo ndonjë nëndarje taksimi, apo politike të tij.

Ky shënim premtimi përbën në lidhje me një hua të dhënë nga Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës për Huamarrësin më

Datë [DATA E DISBURSIMIT].

Në rast vonese për pagesën e menjëhershme dhe të plotë të ndonjë prej shumave të kërkueshme në bazë të këtij shënimi premtues bëhet i kërkueshëm i gjithë principlali dhe interesi për të në datën e pagesës dhe paguhet më vete dhe me kërkesë të zotëruesit të tij.

Mosushtrimi nga zotëruesi i ndonjë prej të drejtave, sipas kësaj, në asnjë rast nuk përbën heqje dorë nga e drejta në këtë rast apo në ndonjë tjetër.

Për HUAMARRËSIN

Shtojca 3B

Shënim premtues model për një hua me interes të përcaktuar

F/P 1570 – [n°]

SHËNIM PREMTUES

[MONEDHA]

[SHUMA]

[DATË]

PËR VLERËN E MARRË, i nënshkruari:

Me anë të këtij shënimi premtues premton t'i paguajë Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës ose një tjetri, shumën principale prej:

[shumën në germa] [monedhën në germa],

Në këste në datat e përcaktuara këtu, dhe interesat siç tregohen më poshtë.

PRINCIPALI

[DATË]

[MONEDHA] [SHUMA]

[DATË]

[MONEDHA] [SHUMA]

[DATË]

[MONEDHA] [SHUMA]

[DATË]

[MONEDHA] [SHUMA]

INTERESI

Fut interesin e parashikuar në letrën shoqëruese

Pagesat e mësipërme bëhen në

[BANKËN KORRESPONDUESE TË CEB-it DHE REFERENCAT E LLOGARIVE],

Në favor të Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës, pa zbritur asnjë taksë, pagesë apo tarifë të tashme ose të ardhshme që caktohet kundër këtij shënimi, ose të ardhurave të saj nga ose në [fut shtetin përkatës] apo ndonjë nëndarje taksimi apo politike të tij.

Ky shënim premtimi përbën në lidhje me një hua të dhënë nga Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës për Huamarrësin më

Datë [DATA E DISBURSIMIT].

Në rast vonese për pagesën e menjëhershme dhe të plotë të ndonjë prej shumave të kërkueshme në bazë të këtij shënimi premtues bëhet i kërkueshëm i gjithë principlali dhe interesi për të në datën e pagesës dhe paguhet me zgjedhjen dhe me kërkesë të zotëruesit të tij.

Mosushtrimi nga zotëruesi i ndonjë prej të drejtave, sipas kësaj, në asnjë rast nuk përbën heqje dorë nga e drejta në këtë rast apo në ndonjë tjetër.

Për HUAMARRËSIN

Shtojca 4
Formulari i raportit ndjekës

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600
 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 10.5.2007
 Doli nga shtypi më 12.5.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Grafon”
 Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë